



**POLITIKAT ME PRIORITET  
NË NIVELIN LOKAL**

**AKADEMIA E GRAVE PËR LIDERSHIP**

**2017**

<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>1</b>
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>3</b>
<b>FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE</b> .....	<b>5</b>
HYRJE .....	7
HISTORIKU DHE PROBLEMET .....	8
QËNDRIMET .....	9
1. POLITIKA PËR STIMULIMIN DHE MBËSHTETJEN E GRAVE NË BIZNES .....	9
2. POLITIKAT QË STIMULOJNË BIZNESET PËR PUNËSIMIN E GRAVE .....	11
3. PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE TË PUNËSIMIT NË NIVEL LOKAL .....	11
KONKLuzionET .....	12
<b>QASJA NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR</b> .....	<b>15</b>
HYRJE .....	17
PËRMBLEDHJE E SFIDAVE DHE BARRIERAVE NË QASJEN NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR DHE POLITIKAT PËR ADRESIMIN E TYRE .....	18
1. POLITIKAT LOKALE NË PËRMIRËSIMIN E MARRËDHËNIES SË QYTETARËVE ME OFRUESIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË NIVELIN PARËSOR .....	20
2. POLITIKA LOKALE NË NGRITJE TË TRANSPARENCËS DHE LLOGA-RIDHËNIES PËRMES RAPORTIMIT TË PARREGULLËSIVE NË NIVELIN PARËSOR TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE NË LUFTIM TË NEPOTIZMIT DHE KORRUPSIONIT .....	21
3. POLITIKA LOKALE RRETH PLANIFIKIMIT DHE SIGURIMIT TË FURNIZIMIT TË DUHUR ME BARËRA NGA LISTA ESENCIALE DHE MATERIALIN SHPENZUES TË BAZUAR NË NEVOJAT KOMUNALE.....	22
<b>QASJA DHE CILËSIA NË ARSIM</b> .....	<b>23</b>
HYRJE .....	25
ARSIMI NË NIVELIN LOKAL: LEGJISLACIONI DHE KOMPETENCAT .....	25
1. ÇËSHTJET PËR AVOKIM NË NIVELIN LOKAL .....	26
1.1. PROMOVIMI I SHKOLLAVE PROFESIONALE DHE PUNËS PRAKTIKE .....	26
1.2. HARTIMI I RREGULLOREVE KOMUNALE PËR ARSIMIN .....	27
1.3. CILËSIA E ARSIMIT DHE AMBIENTI NË SHKOLLA .....	27
REKOMANDIME .....	28
<b>PJESËMARRJA E GRAVE NË POZITA UDHËHEQËSE</b> .....	<b>31</b>
HYRJE .....	33
GRATË NË LIDERSHIP: .....	33
a) PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PARTI POLITIKE .....	33
b) PËRFAQËSIMI I GRAVE NË POZITA VENDIM-MARRËSE .....	35
c) GRATË NË MEDIA .....	36
REKOMANDIMET .....	37



## PARATHËNIE

Shoqëritë në mbarë botën sot ende kanë barriera formale dhe joformale për gratë lidhur me pjesëmarrjen e tyre domethënëse në nivelet lokale dhe nacionale të qeverisjes. Ende në Kosovë gratë vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të konsiderueshme kur janë në kërkim të një posti të zgjedhur ose të emëruar, si dhe të qasjes në udhëheqjen politike. Ne, në Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), besojmë se për gratë që të arrijnë pjesëmarrje kuptimplote në politikë është e nevojshme që udhëheqja politike ta ketë gatishmërinë për të krijuar hapësira më të mëdha për gratë aktiviste brenda partive në mënyrë që ato të jenë në gjendje të zhvillojnë udhëheqjen, rrjetëzimin, avokimin dhe kapacitetet për fushata.

Për të mbështetur gratë dhe partitë politike në tejkalimin e disa prej këtyre sfidave, NDI me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), krijoi Akademinë e Grave për Leadership (AGL). AGL synon t'i ndihmojë gratë që vijnë nga partitë politike në Kosovë që t'i zhvillojnë më tej aftësitë e tyre në leadership, rrjetëzim dhe zhvillim të politikave. Kjo Akademi është vazhdim i aktivitetit Java e Gruas që u ofron pjesëmarrësve trajnime të zgjeruara dhe mundësi aftësimi. Prej pjesëmarrësve të certifikuar nga Java e Gruas 2017, NDI-ja përzgjedhi 30 pjesëmarrëse nga rajone të ndryshme që të marrin pjesë në AGL-në e 5-të. NDI dhe USAID janë krenarë që në këtë publikim t'i paraqesin arritjet e këtyre grave të shquara të Kosovës. Ato morën përsipër sfidën dhe u angazhuan për të deshifruar, analizuar, mbrojtur dhe ndikuar në proceset politike, si dhe për t'i adresuar çështjet e rëndësishme për komunitetet e tyre.

Duke qenë se zgjedhjet lokale në Kosovë do të mbahen në tetor të këtij viti, këtë herë programi i AGL-së është hartuar që t'i ndihmojë pjesëmarrëset në avancimin e aftësive të tyre sa i përket analizës së politikave dhe debatit. Pjesëmarrëset kanë identifikuar dhe hulumtuar çështjet lokale që janë më të rëndësishmet për qytetarët e Kosovës me theks të veçantë problemet e grave. Gjatë pjesëmarrjes së tyre në Akademi, pjesëmarrëset i kanë hartuar katër dokumente të qëndrimeve në temat si arsimi, kujdesi shëndetësor parësor, punësimi, si dhe gratë në udhëheqje mbi të cilat ato e kanë edhe autorësinë. Në kuadër të AGL-së, pjesëmarrëset u trajnuan që t'i artikulojnë gjetjet që ndërlidhen me çështjet e identifikuara dhe i ndanë ato gjetje me udhëheqësit e partive politike.

NDI beson se demokracia e Kosovës do të forcohet atëherë kur aktivistët e shoqërisë civile dhe aktivistët politikë, e në veçanti gratë, të rinjtë dhe pakicat, do të fuqizohen jo vetëm për të identifikuar, kryer dhe siguruar zbatimin e avokimit të bazuar në çështje të caktuara, por edhe duke u dhënë hapësirë dhe resurse aktivistëve politikë që po dalin në skenë që ata/ato t'u bashkohen strukturave partiake dhe t'u mundësohet atyre të marrin pjesë në të gjitha proceset politike, përfshirë këtu edhe zgjedhjet. Për të kristalizuar një bindje të tillë, aktualisht NDI Kosovë është duke implementuar Programin mbi Proceset Politike dhe Mbështetjen Parlamentare në partneritet dhe me financim nga USAID. Qëllimi i përgjithshëm i programit, ku AGL është një nga aktivitetet kryesore, është forcimi i lidhjeve ndërmjet qytetarëve, partive dhe institucioneve, për ta nxitur dhe orientuar qeverinë që t'i përgjigjet më shumë interesit publik.

Në demokracitë e reja, sikurse kjo në Kosovë, forca e partive politike matet me aftësinë e tyre për të qenë sa më përfaqësuese e të gjitha shtresave të shoqërisë duke përfshirë gratë; që të jenë të hapura dhe transparente; dhe që në mënyrë efektive të ndikojnë në politika, në institucione politike, që të bashkohen me partitë e tjera dhe më pas të përfaqësojnë interesin e shoqërisë në përgjithësi. Nëpërmjet këtyre dokumenteve të qëndrimeve, ne presim shumë që këto aktivitete të grave të mund të shihen, dëgjohen dhe vlerësohen nga udhëheqësit politikë. Shpresojmë se gjetjet dhe rekomandimet nga këto dokumenteve të qëndrimeve do t'i pasurojnë platformat politike përpara zgjedhjeve lokale në tetor, dhe, si rrjedhojë, do të japin përfitime më të mëdha për të gjithë kosovarët.

**Alexander Chavarria**

Drejtor

Instituti Kombëtar Demokratik - Kosovë



## METODOLOGJIA

Pas përfundimit të fazës së parë të “Akademisë së Grave për Leadership”, ku gratë pjesëmarrëse kanë ngritur aftësitë e tyre për hulumtim dhe zhvillim të politikave, ato kanë krijuar katër grupe jo formale për të trajtuar: arsimin, kujdesin shëndetësor parësor, punësimin dhe pjesëmarrjen e grave në pozitë vendimmarrëse në nivelin lokal. Duke qenë iniciativë ambicioze dhe me qëllim të ngritjes të mëtutjeshme të aftësive të pjesëmarrëseve, për secilin grup është angazhuar nga një këshilltar me ekspertizë përkatëse që ti ndihmojë anëtarët e grupit me hulumtimin dhe shkrimin e dokumentit të qëndrimeve.

Fillimisht është hulumtuar dhe analizuar korniza legislative që ndërlidhet me fushat përkatëse ku pjesëmarrëset kanë pasur mundësi të mësojnë më shumë për kompetencat e komunave në këtë drejtim. Në bazë të dokumentit themelor të përgatitur nga secili grup, përveç konsultimit të materialeve ekzistuese, pjesëmarrëset me mbështetjen e këshilltarëve kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme me qëllim të sigurimit të informacionit të dorës së parë. Grupet kanë zhvilluar takime të drejtpërdrejta në terren me ekspertë të ndryshëm të fushave dhe zyrtarë komunal të cilët udhëheqin drejtoritë përkatëse, përderisa disa prej grupeve kanë përdorur edhe pyetësor në terren për të nxjerrë të dhëna sasiore.

Pas përfundimit të hulumtimit, grupet kanë vazhduar t’i sistemojnë të dhënat e gjetura në terren dhe ti përpunojnë e analizojnë ato duke përgatitur draftet e para. Për t’i plotësuar këto dokumente me qëndrimet e grave për çështjet e lartpërmendura, gratë kanë organizuar edhe takime konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile, partive politike dhe institucioneve të ndryshme me pjesëmarrës nga të gjitha rajonet dhe etnitë në Kosovë.

Për më tepër gratë kanë prezantuar dhe diskutuar qëndrimet e tyre edhe para Lobit për Barazi Gjinore dhe kanë implementuar aktivitete shtesë në terren për të rritur vetëdijen e qytetarëve lidhur me problemet që përkojnë me temat e lartpërmendura. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve, vizita të ndryshme në shkolla dhe ambulanca për të parë punën dhe problemet e tyre nga afër, pjesëmarrja në tryeza dhe paraqitjet e shumta në media përbëjnë disa nga këto aktivitete.

Duke u bazuar në ekspertizën e ofruar nga këshilltarët, të gjeturat e mbledhura nga terreni, anketat, tryezat dhe publikimet ekzistuese grupet kanë hartuar rekomandimet që kanë për synim përmirësimin e çështjeve përkatëse nga perspektiva gjinore. Në fund, duhet theksuar që dokumentet me qëndrime kanë për qëllim të prezantojnë opinionet për çështje të caktuara me qëllim që të influencojnë audiencat e shënjestruara për idetë dhe rekomandimet për këto çështje.



# FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE

## **AUTORET:**

Ardiana Beka  
Behare Sopa  
Dafina Cacaj  
Dashurije Ahmeti  
Florentina Elezi – Veliu  
Kaltrina Mustafa  
Saranda Llapaj  
Sevdije Hoxha

**KËSHILLTARE:** Arbresha Loxha





**Ardiana Beka**

është profesoreshë e gjuhës angleze në ciklin e mesëm të lartë në Prishtinë. Ardiana e ushtron aktivitetin e saj politik në Lidhjen Demokratike të Kosovës.



**Behare Sopa**

është Këshilltare nga radhët e Partisë Demokratike në Kuvendin Komunal në Suharekë. Beharja po ashtu është kandidatë duke synuar mandatin e dytë si Këshilltare e Kuvendit Komunal në Suharekë



**Dafina Cacaj**

është ekonomiste. Aktivitetin e saj politik e ushtron në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, dega Deçan.



**Dashurije Ahmeti**

është sociologe, ndërsa aktualisht është e angazhuar si Shefe e Sektorit të Rinisë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Ferizajt.



**Florentina Elezi-Veliu**

është Këshilltare nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin Komunal në Drenas. Florentina gjithashtu është kandidatë duke synuar mandatin e dytë si Këshilltare e Kuvendit Komunal në Drenas (2017).



**Kaltrina Mustafa**

është ekonomiste, ndërsa aktualisht punon si zyrtare në kabinetin e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kaltrina e ushtron aktivitetin e saj politik në Lidhjen Demokratike të Kosovës.



**Saranda Llapaj**

aktualisht studion shkencat politike në Universitetin e Prishtinës. Saranda angazhohet në aktivitete të ndryshme të organizuara nga shoqëria civile.



**Sevdije Hoxha**

është ndërmarrëse në Komunën e Skënderajt. Sevdija e ushtron aktivitetin e saj politik në Partinë Demokratike të Kosovës.

## HYRJE

Barazia gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave janë të domosdoshme për arritjen e një zhvillimi gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe sidomos në ç'rrenjosjen e varfërisë në të gjithë botën.<sup>1</sup> Gratë japin kontribut të madh në ekonomi, qoftë në biznese apo si fermere, si sipërmarrëse, punonjëse apo duke bërë punë shtëpiake pa pagesë. Pavarësisht rëndësisë së tyre në ekonomi dhe familje, potenciali i grave është shumë pak i shfrytëzuar, kryesisht për shkak se nuk kanë fare apo vetëm qasje të kufizuar në punë produktive dhe të denjë. Ato gjithashtu janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga varfëria, diskriminimi dhe shfrytëzimi.

Sipas një studimi të Institutit McKinsey Global "plotësimi i boshllëqeve gjinore në shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, puna me gjysmë orari kundrejt punës me orar të plotë së bashku me strukturën e punësimit, do të rriste GDP-në globale për 12-25% deri në vitin 2015. Përfitime të ngjashme të mundshme janë gjetur edhe në studime të tjera, duke përdorur metodologji të ndryshme."<sup>2</sup> Gjithashtu sipas një studimi nga Instituti Demokratik për Zhvillim (D4D) (2015)<sup>3</sup> të gjeturat ekzistuese mbështesin hipotezën se ngushtimi i pabarazive gjinore më konkretisht rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore rezulton në rritje më të madhe ekonomike.

Fuqizimi ekonomik i grave mund të arrihet përmes instrumenteve të ndryshme ku ndër të tjera përfshihen përmirësimi i aftësive të grave për të siguruar punë të denjë, qasja në arsim, qasje dhe kontrollë më të mirë të aseteve, të drejta të barabarta në trashëgimi dhe duke ndikuar në institucione dhe politika publike që përcaktojnë rritjen dhe zhvillimin.

Pjesëmarrja e ulët në tregun e punës dhe papunësia disproporcionalisht më e madhe në mesin e grave, sugjerojnë se rritja e nivelit të përgjithshëm të punësimit në vetvete nuk është e mjaftueshme. Andaj ndikimi i madh në zhvillim mund të arrihet vetëm nëse politikat shënjestërojnë në mënyrë specifike papunësinë e grave<sup>4</sup>.

Përmirësimi i perspektivës së punësimit dhe arritja e qasjes së barabartë në punësim, është një nga instrumentet më të rëndësishme për të promovuar fuqizimin ekonomik të grave. Me fjalë të tjera kjo mund të arrihet përmes zhvillimit të politikave që nxisin dhe mbështesin pjesëmarrje më të lartë të grave në tregun e punës, si dhe në ndërmarrësi. Kjo rrjedhimisht pritet të përmirësojë mirëqenien e grave si dhe fuqizimin e pozitës së tyre në familje dhe shoqëri.

Në kuadër të Akademisë së Grave për Leadership, grupi për ekonomi (tani e tutje grupi) i përbërë nga përfaqësuese të disa partive politike dhe shoqërisë civile, synon të influencoj politikë-bërjen në nivelin lokal me qëllim të përmirësimit të perspektivës së punësimit dhe ndërmarrësisë së grave në Kosovë.

Ky dokument paraqet qëndrimet e grupit lidhur me politikën dhe instrumentet që duhet adoptuar në nivel lokal në mënyrë që të përmirësohet perspektiva e punësimit të grave në Kosovë, bazuar në praktikën më të mirë. Qëndrimet pastaj do t'i prezantohen udhëheqësisë dhe strukturave vendimmarrëse të partive politike në mënyrë që të ndikohet në programin e tyre politik për zgjedhjet e ardhshme lokale. Duhet theksuar që ky dokument nuk përcakton politika dhe instrumente specifike për komunat, thjeshtë ofron alternativa për shqyrtim nëse autoritetet dëshirojnë që në mënyrë më efektive të përmirësojnë perspektivën e punësimit dhe ndërmarrësisë për gratë në Kosovë. Mirëpo

<sup>1</sup> OECD (2011). Fuqizimi Ekonomik i Gruas. <http://www.oecd.org/dac/gender-development/47561694.pdf>

<sup>2</sup> World Economic Forum (WEF). Fuqizimi ekonomik i gruas është veprim i menqur. Çfarë është duke na ndalua?. Publikuar me 17 Janar 2017. <https://www.weforum.org/agenda/2017/01/womens-economic-empowerment-is-the-smart-and-right-thing-to-do-whats-stopping-us/>

<sup>3</sup> Instituti Demokratik për Zhvillim (D4D) (2015). Sa kushton patriarkati? Seria Interesi Publik, No.5. Për më shumë detaje shih: <http://d4d-ks.org/punimet/sa-kushton-patriarkati/>

<sup>4</sup> Instituti Demokratik për Zhvillim (D4D) (2015). Sa kushton patriarkati?. Seria Interesi Publik, No.5. Për më shumë detaje shih: <http://d4d-ks.org/punimet/sa-kushton-patriarkati/>

kësaj duhet fillimisht t'i paraprijë një vlerësim i nevojave të komunave për të vlerësuar se cila nga këto politika është më me prioritet dhe do të plotësonte nevojat e grave në biznes (ose atyre aspiruese) dhe grave në tregun e punës, bazuar në kapacitetet administrative dhe financiare.

## HISTORIKU DHE PROBLEMET

Gratë në Kosovë janë të nën-përfaqësuar në tregun e punës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shifrat e tregut të punës tregojnë se mesatarisht rreth 81% e grave në Kosovë ishin ekonomikisht joaktive gjatë periudhës 2012-2016 dhe vetëm rreth 12% të tyre ishin të punësuar.<sup>5</sup> Rreth 51% të grave janë të punësuar kryesisht në sektorin e arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë. Kurse burrat janë kryesisht të punësuar në sektorin e prodhimit, ndërtimitarisë dhe tregtisë me 44.3%. Papunësia gjithashtu është më e shprehur tek gratë, me 31.8% krahas burrave me 26%. Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare në nivel regjional, pritet që këto dallime të jenë edhe më të përhapura në rajone tjera në krahasim me Prishtinën. Këto dallime mund të jenë rezultat i mundësive më të mira në tregun e punës në Prishtinë pasi që shumica e institucioneve publike, ndërmarrjeve të mëdha dhe misioneve ndërkombëtare janë zakonisht të përqëndruara në kryeqytet.

Sipas D4D (2015), ekzistimi dhe llojet e mundësive për punësim, paga e pritshme, disponueshmëria e shërbimeve të përbalueshme për kujdes të fëmijëve dhe diskriminimi në punësim veçanërisht në sektorin privat janë disa nga faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.<sup>6</sup> Ndërsa USAID (2014) identifikon përgjegjësitë rreth familjes, mungesa e traditës në të bërit biznes, mungesa e ndihmës shtetërore si disa nga pengesat kryesore për pjesëmarrjen e grave në biznes.<sup>7</sup> Një barrierë tjetër e rëndësishme është qasja në financa për shkak të mungesës së hipotekës, që është kryesisht pasojë e pabarazisë në trashëgimi familjare ose mohimit të kësaj të drejte. Për më tepër, rezultatet e anketës së rastësishme me qytetarë, që grupi ka realizuar në kuadër të aktiviteteve të 1 Majit, tregojnë se 61% e të anketuarve konsiderojnë se ju shkelen të drejtat e punës.<sup>8</sup>

Gjithashtu mungojnë të dhëna zyrtare sa i përket grave ndërmarrëse, karakteristikave siç është mosha, kontributi në punësim dhe produktin e brendshëm bruto. Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ABRK), numri i bizneseve të regjistruara nga gratë është rritur në 14.3 për qind në vitin 2016 krahasuar me 12.2 për qind në vitin 2012<sup>9</sup>. Kjo tregon që edhe pse ka tendencë të rritjes, vetëm një pjesë e vogël e bizneseve të regjistruara kanë pronare gra.

Megjithëse politikat e punësimit dhe ndërmarrësisë janë kryesisht përgjegjësi e qeverisë qendrore, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që ndalon komunat të përqafojnë dhe miratojnë politika lokale që nxisin dhe mbështesin punësimin e grave dhe ndërmarrësinë. Sipas nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke

<sup>5</sup> Agjensioni i Statistikave të Kosovës - Të dhënat e tregut të punës. Për më shumë detaje shih: <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712%2f>

<sup>6</sup> Instituti Demokratik për Zhvillim (D4D) (2015). Sa kushton patriarkati? Seria Interesi Publik, No.5. Për më shumë detaje shih: <http://d4d-ks.org/punimet/sa-kushton-patriarkati/>

<sup>7</sup> USAID (2014). "Femrat dhe biznesi: Barazia gjinore në biznes". Analizë e hulumtimit të opinionit public. Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE). Për më shumë detaje shih: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140611153950473.pdf>

<sup>8</sup> Shih metodologjinë për më shumë informacione.

<sup>9</sup> Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ABRK) (2017). Indikatorët bazë të performancës për performancën e bizneseve në Kosovë. Për më shumë detaje shih: <http://arbkrks.gov.net/desk/inc/media/799C86E6-0EFF-438D-93E2-C753E095CFAA.pdf>

i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, ndër të tjera në fushën e zhvillimit lokal ekonomik; planifikimin urban dhe rural dhe shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin. Gjithashtu sipas ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr. 03/L-049, "kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutiv kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm."

Për më tepër, pavarësisht politikave dhe legjislacionit të miratuar në nivel qendror, përmirësimi i pozitës së gruas, fuqizimi dhe motivimi i tyre për t'u marrë me biznes nuk mund të sigurohet pa krijimin e politikave lokale bazuar në nevojat dhe specifikat e komunave.

Nga takimet që kemi realizuar me zyrtarë të 5 komunave<sup>10</sup> dhe hulumtimit të infrastrukturës ligjore dhe praktikave ekzistuese, kemi gjetur se ka praktika që nxisin pjesëmarrjen në tregun e punës, ndërmarrësinë dhe punësimin e grave por që janë të pamjaftueshme (shih kutinë 1)<sup>11</sup>.

## QËNDRIMET

Që nga paslufta, buxheti komunal kryesisht është drejtuar në infrastrukturë. Grupi konsideron se tanimë nevoja për investime infrastrukturore është dukshëm më e ulët, andaj vëmendja duhet të zhvendoset drejt politikave dhe programeve që nxisin dhe mbështesin krijimin e vendeve të punës dhe ndërmarrësinë, veçanërisht në mesin e grave.

Ne konsiderojmë se janë një numër politikash dhe instrumentesh që qeveritë lokale mund t'i implementojnë në mënyrë që të përmirësojnë perspektivën e punësimin të grave në Kosovë të cilat mund të ndahen në tri grupe:

1. Politika për stimulimin dhe mbështetjen e grave në biznes;
2. Politika që stimulojnë bizneset për punësimin e grave;
3. Përmirësimi i praktikave të punësimin në nivelin lokal.

Më konkretisht për secilën prej këtyre politikave kemi identifikuar disa instrumente të mundshme të cilat paraprakisht duhet të vlerësohen edhe më tej në aspektin e kapaciteteve administrative dhe financiare të komunave para se të prezantohen, dhe janë si në vijim:

### 1. POLITIKA PËR STIMULIMIN DHE MBËSHTETJEN E GRAVE NË BIZNES

Për të stimuluar dhe përkrahur bizneset e themeluara dhe të menaxhuara nga gratë, komunat mund të aplikojnë një sërë instrumentesh të cilat janë si vijon:

---

<sup>10</sup> Ferizaj, Pejë, Klinë, Gjilan dhe Skënderaj. Zyrtarët e Komunës së Mitrovicës në pamundësi për të na takuar kanë dërguar përgjigjet në pyetjet tona në mënyrë elektronike.

<sup>11</sup> Për të vlerësuar nëse në nivel lokal egzistojnë politika të cilat synojnë të përmirësojnë pozitën ekonomike të gruas, grupi i ekonomisë në AGL ka përdorur një qasje metodologjike e cila është si vijon: 1) ka takuar drejtoritë për zhvillim ekonomik në Komunën e Pejës, Ferizajit, Gjilanit, Drenasit, Klinës dhe Skënderajit. Gjithashtu kemi provuar të takojmë edhe zyrtarët e Komunës së Mitrovicës dhe Prishtinës mirëpo për shkak të angazhimeve nuk ka qenë e mundur. 2) Pasiqë ka qenë e pamundur në aspektin teknik dhe financiar të vizitohen të gjitha komunat, për komunat e mbetura janë vlerësuar ëbfaqet e tyre për të parë nëse ndonjë praktikë e tillë është evidente. Më konkretisht janë shqyrtuar dokumentet e publikuara, rregulloret, strategjitë dhe raportet e punës.

- ***Ofrimi i stimujve financiar për gratë që fillojnë apo zgjerojnë bizneset e tyre***

Komunat mund të krijojnë një fond për promovimin e ndërmarrësisë së grave, i cili do të ofronte mbështetje financiare në formë të granteve apo subvencioneve për gratë që duan të hapin apo zgjerojnë biznesin. Qasja në financa është njëra ndër barrierat kryesore të të bërit biznes e sidomos në mesin e grave. Përmes këtij fondi komunat do të financonin një pjesë të investimit fillestar apo zgjerimit bazuar në disa kritere me qëllim të lehtësimit të barrës financiare për gratë. Vlera e ndihmës financiare mund të përcaktohet nga vlera e investimit apo kushtëzimit bazuar në numrin e personave të punësuar.<sup>12</sup>

Komunat duhet të thjeshtësojnë procedurat e aplikimit për mbështetje financiare ashtu që të sigurohet një proces gjithpërfshirës dhe të evitohet dekurajimi i grave për shkak të kompleksitetit të procesit.<sup>13</sup> Për më tepër, komunat duhet të ndërmarrin fushata informuese pasi që shumë gra dhe biznese në përgjithësi mbesin pa aplikuar rrjedhimisht, pa përfituar si rezultat i mos informimit.

- ***Përrjashtimi nga detyrimet komunale për bizneset në pronësi të grave***

Komunat në kuadër të kompetencave të tyre kanë mbledhjen e tatimeve komunale, pagesa dhe tarifa për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore, të cilat përveç qytetarëve prekin edhe bizneset. Andaj, një instrument tjetër është përrjashtimi nga detyrimet komunale apo ngarkesat e tjera financiare i bizneseve të udhëhequra nga gratë për një periudhë të caktuar, me qëllim të lehtësimit të barrës financiare në fillim të biznesit. Këtu mund të përrfshihen përrjashtimet nga detyrimet komunale si taksa në biznes, tatimi në pronë, detyrimet që lidhen me shfrytëzimin e hapsirës publike dhe ato me anën komerciale në përrgjithësi, varësisht se cila konsiderohet më relevante për bizneset në fusha të caktuara.

- ***Ofrimi i tokës dhe pronës në shfrytëzim apo me qera***

Ofrimi i tokës në shfrytëzim është një tjetër instrument me të cilën komunat mund të mbështesin dhe stimulojnë gratë në biznes. Sipas Ligjit Nr. 04/L-144 mbi Ndarjen për Shfrytëzim dhe Shkëmbimin e Pronës së Paluajtshme të komunës, komunat mund të japin tokën për përdorim për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë bazuar në kritere të caktuara. Këto kritere përcaktohen më pas me një akt nënligjor. Ekziston një praktikë në pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për të dhënë me qera tokën deri në 99 vjet me tarifa tërheqëse në nivel kombëtar dhe në disa raste edhe në nivel lokal.

---

<sup>12</sup> Për shembull fondi mund të ketë në fokus investimet e bizneseve të grave në sektorin e prodhimit ose investime që përrfshijnë shumë fuqi punëtore në rast se synohet stimulimi i prodhimit në komunat e tyre.

<sup>13</sup> Për shkak të procedurave të nderlikuara bizneset detyrohen të paguajnë konsulent për plotësimin e aplikacionit ngase e kanë të pamundur ta bëjnë vet. Kjo si rezultat përrbën kosto shtesë për bizneset.

- **Hapja e zyreve për këshillëdhënie**

Përveç nevojës për mbështetje financiare, bizneset në Kosovë kanë nevojë për këshillëdhënie dhe asistencë teknike dhe për këtë qëllim komunat mund të hapin zyre për këshillëdhënie për biznese. Element i rëndësishëm i këtyre zyreve është që të ofrojnë këshillim të bizneseve në mënyrë që t'i ndihmojnë ndërmarrësit të përballojnë sfidat e biznesit. Mbi të gjitha, këto zyre mund të ofrojnë ndihmë ose udhëzime për të hartuar një plan biznesi, për të regjistruar biznesin, mundësitë për investime (sektorët me potencial më të madh të rritjes), mundësitë e tjera të financimit dhe granteve si dhe mentorim nga ndërmarrës me përvojë.<sup>14</sup>

## 2. POLITIKAT QË STIMULOJNË BIZNESET PËR PUNËSIMIN E GRAVE

### *Stimulim financiar për bizneset e kushtëzuara në punësimin e grave*

Përveç ofrimit të mbështetjes financiare për bizneset e themeluara dhe të menaxhuara nga gratë, komunat mund të ofrojnë stimulim financiar për bizneset (pavarësisht nga pronësia) për punësimin e grave. Në këtë rast do të nënkuptonte se për të njëjtën punë, një gruaje do t'i jepnin përparësi nëse ajo ka të njëjtat kredenciale si ndërmarrësi burrë. Edhe në këtë rast, komunat mund të themelojnë një fond që do të ofronte ndihmë financiare (grante ose subvencione) bizneseve për secilën grua të punësuar. Stimulimi financiar mund të marrë formën e pagesës së njëhershme për secilën (ose një numër të caktuar) të punësuar apo subvencionimin e pagës për një periudhë të caktuar kohore kushtëzuar me punësimin e një numri të caktuar të grave.<sup>15</sup> Për shembull, Kroacia ofron subvencione nga 3,000-9,000 euro ose mbulon 10-30% të kostove të punësimit, varësisht prej shkallës së papunësisë. Serbia në anën tjetër, ofron 4,000-10,000€ për çdo vend të ri pune kushtëzuar në një vlerë minimale të investimeve dhe personave të punësuar. Megjithatë këto ofrohen për të gjitha llojet e investimeve në nivel qendror, ato lehtë mund të zbatohen edhe në nivel lokal.

## 3. PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE TË PUNËSIMIT NË NIVEL LOKAL

Në mënyrë që të përmirësohet perspektiva e grave, autoritetet lokale duhet gjithashtu të përmirësojnë praktikën e punësimit në komunat e tyre respektive ku ndër të tjera përfshihen:

- Zvogëlimi dhe eliminimi gradual i praktikave diskriminuese në punësim<sup>16</sup>, ngritja në detyrë apo ulja në detyrë, respektimi i të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimi i kushteve dhe sigurisë në vendin e punës.
- Diskriminimi pozitiv i grave në punësim, me kusht që ato kanë të njëjtat kredenciale si homologët e tyre burra, me qëllim të stimulojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe të zvogëlojnë dekurajimin.
- Ngritja e transparencës së procesit të rekrutimit.

---

<sup>14</sup> Komuna e Drenasit ka hartuar Strategjinë për gratë ndërmarrëse për periudhën 2017-2022. Kjo strategji ndër të tjera parashihet "përgatitjen e programeve të posaçme të mentorim dhe këshillim për përkrahje të grave në biznes në të gjitha fazat e veprimitarisë së tyre dhe në bashkëpunim me ministrinë përkatëse".

<sup>15</sup> Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri më e madhe, dhënia e subvencioneve të pagës mund të bëhet në bashkëpunim me punëdhënësin. Subvencionimi mund të jepet në muajt e parë, të mesit dhe të fundit ndërsa pjesën tjetër e mbulon punëdhënësi. Në këtë rast, në vend se të sigurohet punësim të paktën për 6 muaj, sigurohet punësim për një vit.

<sup>16</sup> Të eliminohet gjuha dhe kriteret diskriminuese në konkurse të punësimit si dhe eliminimi i praktiave të përshtatjes së konkursit për burra ose persona të caktuar.

## KONKLuzionet

Është gjithandej e pranueshme që barazia gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave janë jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillim gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe për të zhdukur varfërinë. Potenciali i grave në tregun e punës në Kosovë është jashtëzakonisht i pa shfrytëzuar. Vetëm rreth 19% e grave janë aktive në tregun e punës dhe vetëm 12.7% e tyre janë të punësuar. Gjithashtu, një përqindje modeste e bizneseve të regjistruara përgjatë viteve të fundit kanë pronare gra. Përmirësimi i perspektivës së punësimit dhe arritja e qasjes së barabartë në punësim janë disa nga instrumentet më të rëndësishme për të promovuar fuqizimin ekonomik të grave.

Edhe pse kompetencat kryesore në krijimin e politikave të punësimit kryesisht i takojnë nivelit qendror, grupi konsideron që ka hapësirë të mjaftueshme për qeveritë lokale të hartojnë politika që përmirësojnë perspektivën e punësimit dhe ndërmarrësisë në komunat e tyre, me fokus të veçantë për gratë.

Grupi ka identifikuar tri politika që mund të realizohen përmes disa instrumenteve në kuadër të kompetencave që kanë komunat e që kryesisht janë të natyrës financiare ose këshilluese/teknike dhe ndër më kryesoret janë:

- a) Politika për stimulimin dhe mbështetjen e grave në biznes;
- b) Politikën që nxisin bizneset në punësimin e grave;  
dhe
- c) Përmirësimi i praktikave të punësimit në nivel lokal.

Këto politika mund të jetësohen përmes instrumenteve të ndryshme të tilla si fonde për grante apo subvencione për hapjen apo zgjerimin e biznesit si dhe punësimin e grave. Gjithashtu, përveç ndihmës financiare, bizneset kanë nevojë për këshillëdhënie lidhur me hapjen, regjistrimin apo zgjerimin e biznesit si dhe ndihmë lidhur me mundësitë e financimit, partneritete, trajnime dhe rrjetëzim. Përveç këtyre është mëse e rëndësishme të thjeshtëzohen procedurat e aplikimit për ndihmë financiare (grante apo subvencione) dhe të ketë fushata informuese ashtu që të gjitha gratë apo bizneset në përgjithësi të kanë çasje dhe mundësi të barabarta.

Pasi që komunat kanë karakteristika dhe nevoja të ndryshme, instrumentet e njejta nuk janë të aplikueshme për të gjitha. Andaj cilat nga politikën e lartpërmendura do të miratohen, fillimisht duhet t'i paraprijë një vlerësim se cili nga këto është më me prioritet dhe do të plotësonte nevojat e grave në biznes ose ato aspiruese. Gjithashtu kjo varet nga kapacitetet financiare dhe administrative të komunave.

## **Kutia 1. Praktikrat e mira nëpër komuna të Kosovës që kanë për synim fuqizimin ekonomik të graas**

**Komuna e Ferizajit** në bashkëpunim me Kolegjin UBT ka hartuar 40 udhëzues të detajuar për hapje të biznesit në fusha të ndryshme. Mbështetur nga një donator gjithashtu ka prezantuar praktikën e subvencionimit të pagave - 2,000 euro për një të punësuar për të paktën një vit, ku prioritet u jepet bizneseve të udhëhequra nga nënat vetëushqyese (2 poena më shumë në vlerësim). Gjithashtu, kjo komunë ka themeluar një fond prej 600.000 eurove për subvencionimin e kamatave për bizneset që operojnë në sektorin e bujqësisë në marrëveshje me Bankën për Biznes (BpB). Mirëpo shumë pak gra pëfitojnë nga kjo mundësi për shkak se nuk kanë prona të cilat mund ti lënë hipotekë për të marrë kredi nga banka. Rrjedhimisht nuk kanë mundësi të aplikojnë as për subvencione.

**Në komunën e Pejës** është përcaktuar me rregullore se gratë kanë përparësi në marrjen e tokës në shfrytëzim. Kjo komunë gjithashtu ka mbështetur financiarisht përmes granteve biznese në sektorin e rrobaqepësisë, bukurisë si dhe turizmit më konkretisht guidave turistike në Rugovë, sektorë këta kryesisht të dominuar nga gratë.

**Komuna e Gjilanit** nuk ka të aplikuara asnjë nga praktikrat e lartëpërmendura mirëpo është në proces të hartimit të një strategjie për mbështetjen e grave në biznes.

**Komuna e Mitrovicës së Jugut** gjatë vitit 2015 ka bashkëfinancuar dy projekte:

a) Projektin “Mbështetje të bizneseve të reja për gratë në Jug –Veri të Mitrovicës “e financuar nga Bashkimi Evropian, nga i cili projekt kanë përfituar grante pa kthim 30 gra të nacionaliteteve të ndryshme në vlerë prej 2500-5000 euro. Gjithashtu, 100 gra kanë përfunduar çertifikimin për hulumtim tregu, ndërmarrësi dhe hartim të biznes planit.

b) Bashkëpunim dhe bashkëfinancim të projektit “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë”. Nga ky projekt kanë përfituar 40 biznese, ndërsa nga ky numër 15 prej tyre kanë qenë gra.

Gjithashtu, komuna ka mbështetur 3 pika përpunuese të udhëhequra nga gratë me paisje për përpunim dhe me nga një makinë për bluarje dhe Vitrinë vertikale, kemi disa raste me mbështetje financiare me shuma të caktuara për dëme në agro bizneset e grave.





# QASJA NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR

## **AUTORET:**

Diellëza Rama  
Donikë Dobruna  
Florije Boshnjaku  
Kumrie Hoti  
Leonora Dautaga  
Mediana Bislimi  
Merita Mripa  
Shpresa Llukaj-Goçaj

**KËSHILLTARE:** Adelina Berisha



**Diellëza Rama**

është studente në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Diellëza e ushtron aktivitetin e saj politik në Lidhjen Demokratike të Kosovës, dega në Vushtrri.



**Donikë Dobruna**

është avokate e cila zhvillon aktivitetin në kabinetin e saj të avokaturës në Prishtinë. Donika gjithashtu është bashkëthemeluese e Organizatës Jo Qeveritare "Iniciativa për Mundësi të Barabarta", e cila ka për qëllim mbrojtjen juridike të grupeve të marginalizuara në Kosovë.



**Florije Boshnjaku**

është Këshilltare në Kuvendin Komunal në Rahovec nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Florija ka udhëhequr për një mandat Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec si dhe është kandidatë duke synuar mandatin e katërt si Këshilltare e Kuvendit Komunal në këtë komunë (2017).




**Kumrie Hoti**

është infermiere në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës. Kumria është Këshilltare në Kuvendin Komunal në Podujevë nga radhët e Partisë Demokratike. Kumria gjithashtu është kandidatë duke synuar mandatin e dytë si Këshilltare e Kuvendit Komunal në Podujevë (2017).



**Leonora Dautaga**

është infermiere në QKMF në Gjakovë. Leonora është kandidatë për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Gjakovë nga radhët e Aleancës për Kosovën e Re (2017).



**Mediana Bislimi**

është ekonomiste. Aktivitetin e saj politik e ushtron në Lëvizjen Vetëvendosje, qendra në Gjilan.



**Merita Mripa**

është profesoreshë e gjuhës angleze në ciklin e mesëm të lartë në Mitrovicë. Merita është kandidatë për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Mitrovicë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (2017).



**Shpresa Llukaj-Goçaj**

është Specialiste e Radiologjisë ndërsa aktualisht është e angazhuar si Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit. Shpresa e ushtron aktivitetin e saj politik në Partinë Demokratike të Kosovës.

## HYRJE

Sistemi shëndetësor në Kosovë është i rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti juridik më i lartë, me Ligje të veçanta, siç është Ligji për Shëndetësi si dhe me akte nënligjore. Ligji për shëndetësi, si akt juridik i cili rregullon funksionimin, organizimin dhe zbatimin e politikave shëndetësore ka për qëllim kryesor “sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor”. Neni 4 i ligjit për shëndetësi përcakton detyrat dhe përgjegjësitë në kujdes shëndetësor, përkatësisht përcakton se të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejta të barabarta në kujdesin shëndetësor.

Parimet kryesore mbi të cilat bazohet ky ligj përfshijnë: barazinë, gjithëpërfshirjen dhe jodiskriminimin, cilësinë, ndershmërinë dhe llogaridhënien, dhënien e prioritetit intervenimit kos-efektiv të kujdesit shëndetësor, qëndrueshmërinë dhe vazhdueshmërinë, parandalimin dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe bashkëpërfshirjen dhe solidaritetin.

Institucionet përgjegjëse që garantojnë zbatimin e këtij ligji përfshijnë institucionet shtetërore dhe personat fizik dhe juridik. Këto institucione kanë përgjegjësi të ofrojnë dhe ta organizojnë dhënien e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët pa dallim.

Në bazë të Ligjit për Shëndetësi, sistemi shëndetësor në Kosovë është i ndarë në tri nivele: parësor, dytësor dhe tretësor. Ndërkaq në qendër të këtij hulumtimi është kujdesi parësor.

Kujdesi parësor shëndetësor në Kosovë, sipas Ligjit për Shëndetësi është obligim ligjor i nivelit lokal të qeverisjes. Poashtu, Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Nenin 17 mbi Kompetencat Vetanake të komunave, i obligon komunat të punojnë në ofrimin e përkujdesit publik të shëndetit primar të qytetarëve.

Ligji për shëndetësi kujdesin parësor shëndetësor e rregullon vetëm në aspektin e përgjithshëm, ndërkaq është Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr. 02/2015 mbi organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, që e përcakton në mënyrë më të qartë organizimin dhe funksionimin e këtij sistemi. Sipas udhëzimit administrativ 02/2015, institucionet e kujdesit parësor shëndetësor janë të ndara në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF).

Përveç ligjeve vendore, Kushtetuta e Kosovës e ka të adaptuar edhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, e cila u kërkon shteteve që e kanë adoptuar që të ndërmarrin masa për të “eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e kujdesit shëndetësor në mënyrë që të sigurohet qasja në shërbime shëndetësore”.

## PËRMBLEDHJE E SFIDAVE DHE BARRIERAVE NË QASJEN NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR DHE POLITIKAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Edhe pse qasja në kujdes shëndetësor të dinjitetshëm, mbrojtja dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor është një obligim shtetëror, qeveria e Kosovës në nivelin lokal dhe qendror ende ballafaqohet me sfida të ndryshme, sa i përket ofrimit të kujdesit shëndetësor për qytetarët e saj. Në aspektin e ndarjes së buxhetit, qeveria e Kosovës në vitin 2016<sup>1</sup> ka ndarë vetëm 3.3% të buxhetit për shëndetësi për nivelin qendror dhe 3.1% për nivelin lokal. Mungesa në investime dhe buxheti i mangët për shëndetësi, mund të ndikojnë në shtim të numrit të sëmundjeve (morbiditeti), mungesës së investimeve në ngritje të vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e vizitave të rregullta mjekësore, ofrim të dinjitetshëm të shërbimeve shëndetësore si dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve të Kosovës në qasje në kujdesin shëndetësor parësor. Veçanërisht më të prekura mbesin gratë dhe vajzat, si kategori më e ndjeshme e shoqërisë. Një hulumtim nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës i titulluar “Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë” ka gjetur se gratë, e veçanërisht “gratë në zonat rurale ballafaqohen më tepër me pengesa financiare, kulturore dhe pengesa në marrëdhënien pacient-ofrues të shërbimit në qasjen tek shërbimet shëndetësore, për dallim prej burrave apo grave të tjera nga zonat urbane”.

Gjatë intervistave me 55 qytetarë, prej të cilëve 13 ishin burra dhe 42 gra, të moshës mbi 18 vjeç, grupi hulumtues i AGL-së ka gjetur se qytetarët e Kosovës, kanë disa vështirësi të cilat u pamundësojnë atyre qasje të duhur në kujdesin parësor shëndetësor.

Një prej pengesave që qytetarët kanë shprehur është marrëdhënia jo e duhur mes ofruesve të shërbimeve mjekësore dhe pacientëve. Disa prej të intervistuarve gjatë vizitave derë më derë, janë shprehur të pakënaqur me marrëdhënien dhe shërbimet që atyre u janë ofruar në qendrat e kujdesit shëndetësor në nivelin parësor. Në studimin e realizuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës i titulluar “Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë”, tregon se 53.8% e respondentëve nga zonat rurale dhe 51.4% e respondentëve nga zonat urbane kanë vlerësuar marrëdhënie më të keqe me ofruesit e kujdesit shëndetësor. Ndërsa, një Dokument Veprimi mbi Shëndetësinë në Kosovë i realizuar nga USAID dhe UNDP, ka gjetur se 25% e qytetarëve të Kosovës janë të pakënaqur me shërbimet dhe kujdesin e ofruar nga institucionet e kujdesit parësor shëndetësor.

Shumë pak qytetarë të intervistuar kanë njohuri mbi ekzistencën e kutive të ankesave apo kanë raportuar për parregullësi në sistemin parësor shëndetësor tek institucionet relevante. Kjo gjë ndikon drejtëpërsëdrejti në mungesë të qasjes dhe në trajtim të dinjitetshëm të qytetarëve në shëndetësi, ashtu siç atyre u garantohet me ligj. Një raport i Iniciativës për Progres, ka theksuar se, është vërejtur se stafi profesional në institucionet shëndetësore shpesh përzgjidhet në baza të nepotizmit. Angazhimi i personave jo adekuat në institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor në nivelin parësor, ndikon edhe në ofrim të mangët të shërbimeve shëndetësore. Për më tepër, një gjë e tillë do të paraqes pengesa në qasjen e qytetarëve në këto shërbime, duke ndikuar në uljen e cilësisë së shëndetit të qytetarëve të Kosovës, e veçanërisht të grave dhe vajzave si kategori më të ndjeshme të shoqërisë.

---

<sup>1</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-071%20sh.pdf>

Qytetarët e intervistuar nga AGL janë shprehur se ata shpesh kanë vërejtur se korrupsioni është një nga problemet që atyre u pengon në qasjen në kujdes shëndetësor. Hulumtimi i Lëvizjes Fol ka gjetur se përmes procedurave të prokurimit publik, korrupsioni fillon që nga mënyra e ndërtimit të thirrjes për tenderë, specifikacioneve për tenderin përkatës, duke iu dhënë mundësi dhe përparësi kompanive dhe individëve të caktuar<sup>2</sup>. Hulumtimi i Lëvizjes Fol, Korrupsioni në Institucionet e Kujdesit Shëndetësor Publik në Kosovë ka gjetur se, barnat dhe materiali shpenzues janë produktet që “zhduken” nga institucionet që ofrojnë kujdes shëndetësor”. Në bazë të të gjeturave të hulumtimit, niveli i korrupsionit është më i lartë në zonat rurale sesa në ato urbane. Kjo mund të jetë për shkak se zonat rurale janë më të largëta, ka më pak banorë dhe njihen më shumë në mes vete, ashtu që raportimi i korrupsionit është shumë më i rrallë<sup>3</sup>. Lëvizja Fol ka gjetur poashtu se vetëm 2% e qytetarëve të Kosovës kanë raportuar korrupsionin që ata e kanë hasur në shëndetësi; ngjashëm thonë edhe gjetjet e hulumtimit të RrGGK ku thuhet se vetëm 1.4% e respondentëve kanë raportuar ndonjë shkelje në kujdesin shëndetësor tek institucionet gjyqësore.

Sfidë tjetër e theksuar nga qytetarët dhe stafi mjekësor i intervistuar nga grupi i AGL është edhe mungesa e barërave nga Lista Esenciale dhe materialit shpenzues si dhe mungesa e mjeteve mjekësore, për ushtrimin e dinjitetshëm të profesionit. Qytetarët shpesh është dashur që vet të bëjnë blerjen e produkteve edhe pse ato do të duhej të ishin të disponueshme përmes listës esenciale të barërave. Një udhëheqëse e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë, e intervistuar nga AGL theksoi se: “Nëse buxheti për listën esenciale do t’i ndahej komunave, asnjë qytetar i komunës sime nuk do të mbetej pa pranuar barërat e nevojshme që gjinden në listën esenciale”. Një gjejtje e ngjashme u raportua edhe nga intervista me Lëvizjen Fol, veçanërisht u theksua se kjo mungesë është vërejtur në zonat rurale.

Strategjia Sektoriale për Shëndetësi e vitit 2017-2021 thotë se “Ministria e Shëndetësisë do të fokusohet në përcaktimin e kritereve të qarta të hartimit dhe përditësimit të Listës Esenciale të barnave. Përcaktimi i këtyre kritereve ka për qëllim një listë të bazuar në të dhëna dhe që reflekton mundësitë reale buxhetore, me pacientin në qendër të vëmendjes”.

Gjetje të tjera tregojnë se, në QMF dhe AMF ka mungesë të stafit teknik. Për pasojë, në këto institucione shëndetësore, shpeshherë duhet që infermierët të merren me higjienën, mirëmbajtjen dhe ngrohjen e objekteve. Angazhimi i infermierëve në detyra që nuk përkojnë me punën e tyre, mund të ndikoj në uljen e performacës së punës, si dhe në uljen e ofrimit të shërbimit cilësor për qytetarët.

Duke u bazuar në këto sfida, konsiderojmë se komunat mund të miratojnë një numër politikash dhe masa afirmative me qëllim të ofrimit të qasjes së duhur në kujdesin parësor shëndetësor për qytetarët e tyre. Këto politika mund të ndahen në:

1. *Politikat në përmirësimin e marrëdhënies së qytetarëve me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në nivelin parësor;*
2. *Politika në ngritje të transparencës përmes raportimit të parregullësive në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor;*

---

<sup>2</sup> Nga intervista e AGL me Z. Petrit Zogaj, Drejtor Ekzekutiv në Lëvizjen Fol.

<sup>3</sup> Nga po e njejta intervistë.

3. *Politika për planifikim të bazuar në nevojat reale në komuna në mënyrë që ofrimi i shërbimeve gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor të jetë në pajtim me nevojat e komunitetit.*

## **1. POLITIKAT LOKALE NË PËRMIRËSIMIN E MARRËDHËNIES SË QYTETARËVE ME OFRUESIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË NIVELIN PARËSOR**

- **Trajnime shtesë për stafin profesional:** Drejtorët e QKMF-ve në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë të komunave mund të organizojnë trajnime në bashkëpunim me Odat e Profesionistëve Shëndetësor për stafin profesional mbi etikën e punës dhe krijimin e marrëdhënieve më të mira me pacient, ashtu siç kërkohet në bazë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor si dhe Udhëzimit Administrativ 02/2015 neni 17 mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional. Poashtu, me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcaktohen kompetencat e komunave me ç'rast ato obligohen që ndër të tjera të punojnë edhe në ofrimin e përkujdesit publik parësor shëndetësor.
- **Inkurajimi i specializimit në fushën e mjekësisë familjare:** Një nismë tjetër që do të mund të ndikoj në uljen e mungesës së stafit profesional në komuna, do të ishte edhe stimulimi dhe inkurajimi i specializimit në fushën e mjekësisë familjare për specializantët e mjekësisë në komunat specifike ku paraqitet si e nevojshme. Kjo mund të bëhet përmes motivimit të specializantëve, duke u ofruar kontrata të cilat atyre u garantojnë se pas specializimit do të ju ruhet vendi i punës.
- **Krijimi i kushteve të përshtatshme për personelin dhe pacientët:** Përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetarët e komunave duhet të bëjnë presion në nivelin qendror që të rritet buxheti për shëndetësi për nivelin lokal, në mënyrë që të përmirësohet qasja në kujdesin shëndetësor parësor. Rritja e buxhetit do të ndikoj pozitivisht në cilësinë e shërbimeve shëndetësore përmes rritjes së numrit të stafit mjekësor, stafit ndihmës, furnizim me mjetet e punës dhe paisjet mjekësore.
- **Të rritet numri i stafit mjekësor në AMF dhe QMF:** Duke qenë se në shumicën e QMF-ve dhe AMF-ve ka mungesë të stafit mjekësor, drejtoritë komunale për shëndetësi mund ta kontraktojnë shërbimin e higjienës për të mundësuar rritjen e numrit të stafit mjekësor.
- **Krijimi i ekipeve mobile:** Drejtoria e shëndetësisë në komunat me më pak se 150 mijë banorë, ku nuk ekzistojnë Qendrat e Mjekësisë Urgjente, të krijojnë ekipe mobile në gatishmëri, të cilët do të ishin në shërbim të qytetarëve që jetojnë në zona më të largëta dhe që qasjen në institucione shëndetësore të nivelit parësor e kanë të kufizuar.

## 2. POLITIKAT LOKALE NË NGRITJE TË TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES PËRMES RAPORTIMIT TË PARREGULLËSIVE NË NIVELIN PARËSOR TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE NË LUFTIM TË NEPOTIZMIT DHE KORRUPSIONIT

- **Vizita më të shpeshta në QMF dhe në AMF:** Për të adresuar këto çështje, është vlerësuar se do të ishte e nevojshme të bëhen vizita më të shpeshta në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe në Ambulancat e Mjekësisë Familjare për t'u siguruar se stafi i angazhuar e respekton orarin. Këto vizita duhet të realizohen nga personat e autorizuar nga drejtoria e shëndetësisë në komunat përkatëse.
- **Funksionimi i komiteteve etiko-profesionale:** Në kuadër të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale duhet të fuqizohet funksionimi i komiteteve etiko-profesionale të përbëra nga drejtorët e shëndetësisë në komunë, nga stafi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe një përfaqësues nga shoqëria civile, e të cilët do të shqyrtojnë shkeljet e mundshme të kodit të etikës dhe më pas të ndërmarrin masa disiplinore në pajtim me rregulloret e punës.
- **Fushata vetëdijesuese me qytetarët:** Ngritja e vetëdijës së qytetarëve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përmes takimeve të vazhdueshme për t'i vetëdijësuar mbi Ligjin për Shëndetësi si dhe kartën e drejtave të pacientit. Kjo mund të arrihet përmes implementimit të strategjisë për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë, takimeve të rregullta me qytetarë, fushatave vetëdijesuese dhe bashkëpunim me shoqërinë civile.
- **Krijimi i komisioneve për shqyrtim të ankesave:** Të krijohen dhe të funksionalizohen komisionet për trajtimin e ankesave të pranura në institucionet shëndetësore të sistemit parësor. Përveç kësaj, drejtoritë e komunave mund të përdorin teknologjinë moderne për të ngritur transparencën. Kjo mund të bëhet përmes dizajnit të platformave specifike për komunën, ku qytetarët mund të dërgojnë ankesat e tyre online. Verifikimi i këtyre ankesave të bëhet nga një përfaqësues i QKMF-së, drejtorisë së shëndetësisë, një qytetar dhe një përfaqësues i shoqërisë civile dhe të veprohet menjëherë pasi të analizohet ankesa.
- **Raportime më të shpeshta pranë kuvendit:** Drejtoritë komunale për shëndetësi duhet të përpilojnë raporte të detajuara tre mujore mbi gjendjen e shëndetësisë në komunë, raporte të cilat do të paraqiten para asambleistëve të kuvendit komunal.



### **3. POLITIKA LOKALE RRETH PLANIFIKIMIT DHE SIGURIMIT TË FURNIZIMIT TË DUHUR ME BARËRA NGA LISTA ESENCIALE DHE MATERIALIN SHPENZUES TË BAZUAR NË NEVOJAT KOMUNALE**

- **Furnizim në bazë të nevojave të komunës:** Kryetarët e komunave përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës të avokojnë në nivelin qendror që furnizimi me barëra të bëhet në bazë të nevojave dhe specifikacioneve të komunave. Të bëhet decentralizimi i buxhetit sa i përket Listës Esenciale dhe materialit shpenzues.
- **Furnizim përmes të hyrave vetanake:** Në rastet kur komuna ka mungesë të ndonjë medikamenti specifik nga Lista Esenciale dhe Materialet Shpenzuese atëherë drejtorja e shëndetësisë mund të shfrytëzoj buxhetin nga të hyrat vetanake të komunës në mënyrë që të ofrohet qasja e duhur dhe shpërndarja e barërave të bëhet në mënyrë të rregullt për pacientët.

# QASJA DHE CILËSIA NË ARSIM

## **AUTORET:**

**Amanda Toska**

**Berita Abazi**

**Eldita Mullahasani**

**Fatjona Hoti**

**Havë Qarri**

**Lindita Bellaja**

**Luljeta Mulliqi – Zeqiri**

**KËSHILLTAR:** Artan Murati



**Amanda Toska**

është aktiviste për të drejtat e anëtareve nga komunitetet Rom, Ashkanlinj dhe Egjiptian. Amanda është e fokusuar në edukimin e fëmijë ve nga këto komunitete në kuadër të OJQ VORAE.



**Berita Abazi**

është studente në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Berita e ushtron aktivitetin e saj politik në kuadër të Lëvizjes Vetëvendosje, qendra në Prishtinë .



**Eldita Mullahasani**

është profesoreshë e gjuhës shqipe në ciklin e mesëm të lartë në Gjakovë. Aktivitetin e saj politik e ushtron në kuadër të partisë Alternativa.



**Fatjona Hoti**

është studente në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës ndërsa aktualisht punon si asistente ligjore në Bankën Ekonomike. Fatjona e ushtron aktivitetin e saj politik në Aleancën Kosova e Re.



**Havë Qarri**

është zyrtare e lartë e prokurimit në Komunën e Shtimes. Hava është menaxhere e fushatës për Zgjedhjet Lokale 2017 në Partinë Demokratike të Kosovës, dega Shtime.



**Lindita Bellaja**

është eksperte në Menaxhim të Emergjencave Civile, Siguri në Punë dhe Mjedis. Lindita është kandidate për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Gjakovë (2017) nga rradhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.



**Luljeta Mulliqi-Zeqiri**

aktualisht punon si asistente në kolegjin ISPE. Luljeta është kandidate për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Prishtinë (2017) nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

## HYRJE

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar në procese të ndryshme intenzive transformuese. Masat e para u ndërmorën për të vendosur shtyllat kryesore mbi të cilat do të zhvillohej reforma arsimore në sistemin e arsimit në Kosovë. Përmes një sistemi arsimor të zhvilluar, vendi ynë do të ketë mundësi të jetë konkurrent i dijes krahas vendeve më të zhvilluara botërore. Duke pasur parasysh faktin se të rinjtë përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë së vendit, çështja e arsimit duhet të trajtohet me prioritet nga institucionet e pushtetit qendror dhe lokal të Republikës së Kosovës.

Përkundër investimeve dhe zhvillimeve të shumta në fushën e arsimit, një ndër sektorët më të rëndësishëm të shtetit vazhdon të përballet me sfida të ndryshme, nga ato përmbajtësore e deri tek ato të karakterit teknik e infrastrukturor. Institucionet e Republikës së Kosovës, qoftë ato të nivelit qendror apo lokal, duhet të mbesin të angazhuara të kryejnë me përpikëri të gjitha detyrat dhe obligimet që kanë sipas legjislacionit në fuqi, kurse partitë politike në vend duhet të promovojnë dhe të garantojnë zhvillimin e arsimit përmes platformave të tyre politike.

Ky dokument do të shërbejë si instrument avokimi tek institucionet relevante në vend për përfshirjen e disa prej çështjeve të rëndësishme për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor, me fokus të veçantë në nivelin lokal. Përmes këtij dokumenti, do të synohet përfshirja e disa aspekteve të rëndësishme të arsimit në platformat politike të subjekteve që do të garojnë në zgjedhjet lokale të vitit 2017.

## ARSIMI NË NIVELIN LOKAL: LEGJISLACIONI DHE KOMPETENCAT

Kompetencat e pushtetit lokal në fushën e arsimit rregullohen me anë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i miratuar në vitin 2008. Sipas këtij ligji, organet komunale kanë për obligim *“ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”*.<sup>1</sup>

Për më tepër, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, specifikon edhe më shumë kompetencat e pushtetit lokal, ku ndër të tjera parasheh edhe një sër obligimesh të cilat duhet përmbushur nga Komunitet. Poashtu, Ligji për Arsimin në Komuna specifikon në detaje detyrimet e komunave dhe në veçanti drejtorive komunale të arsimit (DKA-ve) në krijimin e kushteve dhe garantimin e zhvillimit të procesit mësimor.<sup>3</sup> Përveç ligjeve të lartëcekura, MASHT ka nxjerrur edhe një numër të madh të udhëzimeve administrative, të cilat rregullojnë në detaje aspekte specifike të arsimit parauniversitar, e ku pushteti lokal luan rol shumë të rëndësishëm në përmbushjen e detyrave të parapara me këto udhëzime.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, neni 17(h): <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530> (qasur me 07 qershor 2017)

<sup>2</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar 04/L-032, neni 7(3): <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770> (qasur me 07 qershor 2017)

<sup>3</sup> Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543> (qasur me 07 qershor 2017)

<sup>4</sup> Disa nga udhëzimet administrative janë: Udhëzim Administrativ Nr.490/1B/2011 mbi Kodin e Etikës për vlerësimin e nxënësve, Udhëzim Administrativ Nr. 40 / 2005 Ndalimi, ndërprerja e punës dhe inicimi i procedurës disiplinore ndaj mësimitdhënësve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore, Udhëzues për Normat dhe Standardet e ndërtesave Shkollore, Udhëzimi

## 1. ÇËSHTJET PËR AVOKIM NË NIVELIN LOKAL

Organet e pushtetit lokal në Republikën e Kosovës janë bartëset kryesore të arsimit parauniversitar. Duke pasur parasysh këtë fakt, tri çështjet e identifikuar nga grupi joformal për arsim hyjnë në kuadër të kompetencave të organeve komunale, më konkretisht DKA-ve, duke u mundësuar atyre përmirësimin e gjendjes aktuale.

Tri çështjet kryesore të cilat konsiderojmë që duhet të jenë prioritet për pushtetin lokal në komunat e Kosovës gjatë mandatit të ardhshëm qeverisës: janë promovimi i shkollave profesionale dhe punës praktike, hartimi i rregulloreve komunale për arsim si dhe intervenimi për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e ambientit mësimor në përgjithësi. Hulimtimi i gjendjes aktuale rreth çështjeve të evidentuara është realizuar në 23 komuna të Kosovës, ku janë realizuar vizita në shkolla të mesme profesionale, takime me drejtorë të DKA-ve si dhe intervista me më shumë se 400 nxënës, 200 mësues dhe 100 prindër.

Në vazhdim do të elaborohen çështjet kryesore për avokim tek partitë politike, ku synohet përfshirja e këtyre aspekteve të arsimit parauniversitar në platformat politike të partive që garojnë në zgjedhjet lokale të 22 tetorit.

### 1.1. PROMOVIMI I SHKOLLAVE PROFESIONALE DHE PUNËS PRAKTIKE

Shkollat e mesme profesionale në Republikën e Kosovës ofrojnë drejtime të shumta studimi të cilat janë atraktive dhe relevante me kërkesat e tregut të punës në vend. Megjithatë, mungesa e trajtimit adekuat të këtyre shkollave nga drejtoritë komunale është duke krijuar probleme të natyrave të ndryshme. Shkollat nuk janë të pajisura me punëtori e kabinete të posaçme ku mund të kryhet praktika profesionale brenda shkollës, ka mungesë të theksuar të literaturës si dhe mungojnë programe për përfundimin e praktikës profesionale. Përveç pengesave në realizimin e mësimin praktik brenda shkollës, nxënësit vazhdojnë të përballen me pengesa edhe nëse dikush nga ta mëton të angazhohet në mësim praktik jashtë shkollës, qoftë në sektorin publik apo në atë privat. Përderisa institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror vazhdojnë të ofrojnë pak programe të praktikës profesionale për nxënësit, sektori privat mbetet më lehtë i qashtë në këtë drejtim. Mirëpo, edhe përkundër dëshirës së nxënësve, as sektori privat as ai publik nuk ofrojnë mundësi të shumta që do të ndikonin në ngritjen e kapaciteteve profesionale të nxënësve. Nxënësit konstatojnë që në shumë raste kompanitë u ofrojnë atyre detyra të cilat nuk përkojnë me drejtimin që ata kanë dhe të njëjtit janë të detyruar të kryejnë punë dytësore në ato firma, edhe pse firmat dhe shkollat janë të obliguara të përpilojnë kontrata ku specifikohen detyrat e punës së praktikantëve konform drejtimit të cilin ata ndjekin në shkollë.

Shkollat profesionale në shumicën e rasteve konsiderohen si shkolla të dorës së dytë, dhe në përgjithësi ekziston përshtypja se nxënësit e shkëlqyeshëm duhet të vazhdojnë studimet vetëm në gjimnaze.

Mungesa e iniciativave për digjitalizimin e shkollave ose kabineteve profesionale, përpilimi i teksteve për lëndët profesionale që për rrjedhojë sjellë diktimin (dhënien e shënimeve) poashtu janë duke e dëmtuar procesin mësimor nëpër shkolla.

## 1.2. HARTIMI I RREGULLOREVE KOMUNALE PËR ARSIMIN

Roli dhe përgjegjësitë e komunave janë përcaktuar me Ligjin për Arsimin në Komunitet. Me këtë Ligj është rregulluar aspekti i organizimit të institucioneve arsimore publike dhe qasja në arsim publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunitet e Republikës së Kosovës. Dhënia e kompetencave për komunitet apo shkollat në fushën e arsimit dhe qartësimi i mëtutjeshëm i këtyre kompetencave përmes një rregulloreje të veçantë komunale e bazuar në këtë ligj është e domosdoshme. Kjo është dëshmuar në dy komuna (Prishtinë dhe Shtime), të cilat tashmë kanë të miratuar një rregullore të tillë. Me anë të rregulloreve komunale për arsimin, komunitet do të përcaktojnë rregullat bazë me anë të së cilave shkollat do ta kishin më të lehtë funksionimin e tyre. Këto rregullore do t'u mundësojnë shkollave të rregullojnë në mënyrë të njëjtë disa nga proceset kryesore që kanë të bëjnë me arsimin parauniversitar, siç janë: regjistrimi i nxënësve, mbajtja e uniformës, sigurimi në shkollë, masat disiplinore, aktivitetet jashtëmësimore, etj.

Një çështje shumë e rëndësishme e cila duhet të rregullohet me rregullore komunale është shqiptimi i masave edukativo-disiplinore. Masat edukativo-disiplinore për nxënës në situatën aktuale nuk janë duke prodhuar efekte pozitive. Transferimi i nxënësve nga një shkollë në një tjetër vetëm transferon problemin, por nuk e zgjidhë atë. Andaj, DKA-të përmes rregulloreve komunale duhet të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme për këtë problem, duke respektuar udhëzimet administrative në fuqi që parashohin këto sanksione.

Poashtu, gjatë hulumtimit në terren është vërejtur se shumica e shkollave fillore dhe të mesme nuk kanë rregullore të shkollës. Hartimi i rregulloreve të punës së shkollave është e paraparë me Ligjin për Arsimin në Komunitet. Hartimi i rregulloreve do të ngriste kualitetin në procesin edukativo arsimor, nivelin e disiplinës të personelit dhe nxënësve, përgjegjësinë në punë dhe mësim, respektimin e kodit të mirësjelljes, respektimin e orarit të punës dhe procesit mësimor në përgjithësi.

## 1.3. CILËSIA E ARSIMIT DHE AMBIENTI NË SHKOLLË

Nga hulumtimi i bërë në terren, janë evidentuar disa probleme sa i përket aspekteve të ndryshme që lidhen me cilësinë e arsimit dhe ambientin mësimor.

Një nga problemet më të mëdha të evidentuara është organizimi i mësimin zgjedhor në shkollë të mesme. Të dhënat nga terreni tregojnë që mësimi zgjedhor në përgjithësi nuk aplikohet si duhet, dhe shpesh nuk është në përputhje me nevojat dhe interesat e nxënësve.

*“Nxënësit nga klasa ime që ndjekin kurse private në lëndën e Informatikës dhe Gjuhës Angleze notohen automatikisht me notë maksimale nga mësimdhënësit”*

**Altini, nxënës nga F.Kosova**

fakti që (mos)ndjekja e kurseve private ka ndikim direkt në procesin e notimit në shkollë, duke konstatuar që nxënësit që ndjekin kurse private vlerësohen më mirë.

Me gjithë zgjerimet dhe riparimet e shumta të financuara nga komunitet dhe donatorët e ndryshëm, në shumë shkollë klasat janë të vogla, ka mungesë të bankave, karrigeve dhe mjeteve të punës.

Element tjetër që ndikon në mbarëvajtjen e procesit mësimor, e sidomos në vlerësimin (notimin) e nxënësve është edhe organizimi i kurseve private nga ana e mësimdhënëseve. Ajo çfarë është shqetësuese në këtë aspekt është

*“Mbetem e shqetësuar për çdo ditë për fëmijun tim, sepse në rast të ndonjë fatkeqësie nga zjarri, shkollë nuk ka madje as shkallë emergjente për evakuim”*

**Ariana, nënë nga Prishtinë**

Shumë shkolla nuk kanë shkallë emergjente apo plane për evakuim në rast të situatave emergjente. Shumica e shkollave në Kosovë poashtu nuk kanë hapësira dhe mekanizma adekuat për nxënësit me aftësi të kufizuara, si hyrjen speciale në shkollë, mekanizmat e shkallëve apo tualetet e veçanta. Poashtu, shumica dërmuese e shkollave nuk kanë dollape apo hapësira ku nxënësit mund të vendosin dhe ruajnë librat dhe gjërat e tyre personale.

Problemet më të mëdha sa i përket ambientit të jashtëm të shkollës konsiderohen mos-rregullimi adekuat i trafikut, ku në shumicën e rasteve mungojnë semaforët, vendkalimet për këmbësorë, policët e shtrirë por edhe shenjat e komunikacionit që paralajmërojnë hyrjen në zonë të shkollës. Në shumë raste përreth shkollës funksionojnë shumë kafiteri dhe lojëra të fatit, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në sigurinë e nxënësve.

Gjatë hulumtimit të realizuar në terren, dhe sidomos gjatë bisedës me prindër, është evidentuar se në shumicën e komunave ku transporti i nxënësve nga shtëpia në shkollë është i organizuar me minibus përcillet me probleme. Shqetësimi më i madh i ngritur nga prindërit në këtë aspekt është numri shumë i madh i nxënësve të vendosur në minibus, ku shumicën dërmuese të rasteve këta minibus janë të stërngarkuar dhe jashtë normave të lejuara me ligj. Ky fakt paraqet edhe rrezik për jetën dhe shëndetin e fëmijëve.

Edhe mungesa e kopshteve për fëmijë paraqet problem të theksuar në zhvillimin profesional të fëmijëve, duke filluar nga moshën e re. Sipas hulumtimeve të kryera, fëmijët që shkojnë në kopsht dhe ndjekin mësimin parashkollor arrijnë rezultate më të mira në mësim në momentin kur fillojnë shkollimin formal. Komunitet në Republikën e Kosovës, e më konkretisht DKA-të, duhet të fokusohen më shumë drejt krijimit të kopshteve me bazë në komunitet, veprim ky që do të përmirësonte edhe cilësinë e arsimit për periudhë afatgjatë.

## REKOMANDIME

Pas analizimit të gjendjes faktike në terren dhe pas rishikimit të kompetencave të organeve komunale, grupi për arsim në kuadër të Akademisë së Grave për Leadership, rekomandon:

### Lidhur me shkollat profesionale:

- Komunitet në të cilat mungojnë Qendrat për Këshillim në Karrierë duhet të themelojnë këto Qendra, të cilat do të mundësojnë lidhjen e shkollave profesionale me tregun e punës;
- Komunitet të krijojnë dhe mirëmbajnë një platformë online me të gjitha informacionet rreth arsimit profesional në komunë;
- Komunitet të nënshkruajnë marrëveshje me institucione publike dhe private për mundësimin e zhvillimit të praktikës profesionale për të gjithë nxënësit;
- Praktika profesionale të jetë gjithpërfshirëse dhe t'u mundësohet të gjithë nxënësve, pavarësisht rezultatit të tyre në mësimin formal në shkollë;
- DKA dhe shkollat profesionale të monitorojnë praktikën profesionale të nxënësve, për të siguruar mbarëvajtjen e saj;
- Komunitet dhe shkollat profesionale të jenë më aktive në fushatat vetëdijesuese për mundësitë në punësim pas përfundimit të shkollave profesionale për të rinjtë;
- DKA në bashkëpunim me MASHT të sigurojnë literaturën e nevojshme për lëndët profesionale, dhe të evitohet diktimi i materialit gjatë orëve mësimore;
- DKA-të të sigurojnë shkollat me punëtori, laborator e kabinete funksionale në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i mësimin praktik brenda shkollës.

### Lidhur me rregulloret komunale:

- Komunat të marrin hapa konkret në hartimin e rregulloreve komunale të arsimit;
- Komunat individualisht duhet të kenë plane zhvillimore/arsimore komunale (të ndara apo të integruara në planet e përgjithshme të zhvillimit);
- Inkurajohen shkollat të draftojnë rregulloret e punës, kurse DKA-të të asistojnë shkollat të cilat synojnë hartimin e rregulloreve, ashtu siç është e përcaktuar me ligj;
- Të formohen grupe punuese të përbërë nga mësimdhënësit, nxënësit, udhëheqësit e institucioneve arsimore, zyrtarë komunal dhe ekspertë të arsimit, ku do të përcaktohej për përmbajtjen e rregullores komunale për arsim;
- DKA-të të rishqyrtojnë masat disiplinore për nxënësit që bëjnë shkelje të Kodit Dicipinor;
- DKA-të në koordinim me MASHT-in të ndërmarrin hapa të përbashkët në harmonizimin e masave disiplinore të parapara me Udhëzim Administrativ dhe Rregullore Komunale.

### Lidhur me cilësinë dhe mjedisin mësimor:

- Lëndët zgjedhore të përcaktohen me iniciativë dhe konsultim me nxënësit;
- DKA-të duhet të sigurojnë hapësira të mjaftueshme brenda shkollës për realizimin e punës praktike;
- DKA-të dhe Inspektorati i Arsimit të marrin masa adekuate për të ndaluar mbajtjen e kurseve nga ana e mësimdhënësve të shkollave publike;
- Në vend të kurseve private shkollat të ofrojnë orë plotësuese, për të gjithë nxënësit e interesuar;
- DKA-të të sigurojnë që secila shkollë të ketë shkallët emergjente, të ekzistoj plani për evakuim në rast të emergjencave, si dhe stafi dhe nxënësit të trajnohen për situata të tilla;
- Secila shkollë të krijoj qasjen për nxënës me aftësi të kufizuara;
- Organet komunale duhet të bëjnë evidentimin dhe mbylljen kafiterive, lojërave të fatit ose lokaleve të videolojërave në afërsi të shkollave;
- DKA-të të ndërmarrin hapa në mbrojtjen e shëndetit të nxënësve në shkollë, duke bërë zëvendësimin e tabelave të vjetra dhe shkurtesave me tabela plastike dhe markerëve me ngjyrë;
- DKA-të të ndërmarrin iniciativa përmes projekteve nga donatorë të jashtëm për të filluar digjitalizimin e mësimin në mënyrë graduale;
- Transporti i nxënësve nga zonat rurale të realizohet në mënyrë të duhur, me minibus komod e me numër të limituar të nxënësve, duke u kujdesur për jetën dhe shëndetin e tyre;
- Procesi i përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave të depolitizohet dhe zgjedhja të bëhet në bazë të meritokracisë dhe përvojës së dëshmuar.





# PJESËMARRJA E GRAVE NË POZITA UDHËHEQËSE

## **AUTORET:**

**Afërdita Morina-Biffar**

**Ardelina Pacolli**

**Egzona Gashi**

**Rrezarta Berisha**

**Rreze Abdullahu**

**Tringa Kasemi**

**Yllkë Neziri**

**KËSHILLTARE:** Ariana Qosaj – Mustafa



**Afërdita Morina-Biffar**

ushtron aktivitetin e saj politik në Lidhjen Demokratike të Kosovës, dega në Prizren. Afërdita ka qenë kandidate për deputete nga radhët e LDKsë në Zgjedhjet e Përgjithshme 2017.



**Ardelina Pacolli**

është angazhuar si këshilltare në zyrën e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ardelina është kandidate për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Prishtinë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (2017).



**Egzona Gashi**

është psikologe. Egzona e ushtron aktivitetin e saj politik në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Han i Elezit.



**Rrezarta Berisha**

është ekonomiste, ndërsa aktualisht është e angazhuar si agjente e jashtme në INSIG. Rrezarta ushtron aktivitetin e saj politik në Partinë Demokratike të Kosovës, dega në Decan.



**Rreze Abdullahu**

është psikologe dhe aktiviste për barazi gjinore dhe feminizëm. Rrezja është e angazhuar si Kryeredaktore në magazinën Barazia.



**Tringa Kasemi**

është aktiviste në shoqërinë civile në Prizren ku ka bashkë inicuar grupin joformal Femaktiv që synon fuqizimin e grave dhe vajzave. Tringa aktualisht është e angazhuar si Koordinatore e Programit në KDI në Prizren.



**Yllkë Neziri**

është ekonomiste, ndërsa aktualisht është e angazhuar si kontabiliste në Kompaninë Regionale të Mbeturinave "Pastërtia". Yllka është kandidate për Këshilltare në Kuvendin Komunal në Ferizaj nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (2017).

## HYRJE

Kjo përmbledhje e shkurtë e analizës ofron të gjetura dhe rekomandime kryesore lidhur me rritjen e përfaqësimit të grave brenda partive politike si dhe në vendim-marrje duke synuar që këto rekomandime të ndahen me partitë politike para zgjedhjeve lokale. Të gjeturat janë nxjerrë nga analiza e ligjeve ekzistuese, politikat brenda partive politike, hulumtimit të raporteve ekzistuese si dhe diskutimeve me gratë nga shoqëria civile dhe politika lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë në Kosovë.

Për më tepër, është bërë edhe një hulumim i shkurtër në terren në shtatë rajone të Kosovës nga grupi i grave pjesëmarrëse në Akademinë e Grave për Leadership 2017. Analiza poashtu është e bazuar edhe në disa prej trendeve aktuale në përfaqësimin e rolit të gruas nga partitë politike dhe mediat gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të mbajtura me datën 11 qershor 2017. Ky dokument i qëndrimeve tenton të ofroj kontribut në diskutimin e rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë gjatë zgjedhjeve të ardhshme lokale duke identifikuar mundësitë e ardhshme për promovimin e pjesëmarrjes së grave në këto procese.

## GRATË NË LIDERSHIP:

### a) PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PARTI POLITIKE

Ligjet për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale përfshijnë kuotën prej 30% të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht në kuvendet komunale.<sup>1</sup> Poashtu Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës (2015) kërkon ndryshimin në përfaqësimin e grave brenda partive politike. Për më tepër, në zgjedhjet qendrore të datës 11 qershor 2017 është respektuar vetëm pjesëmarrja sipas kuotës së paraparë prej 30% në kundërshtim me kërkesat e qarta të Ligjit për Barazi Gjinore.<sup>2</sup> Sipas këtij ligji të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015 Nr. 05/L-020, parashihet që partitë politike do të duhej të respektojnë parimin e barazisë ku sigurohet përfaqësimi prej 50% për secilën gjini, në përputhje me nenet 5, 6 dhe 14 të Ligjit për Barazi Gjinore.<sup>3</sup> Specifikisht LBGJ në nenin 14 parasheh që “Partitë politike me aktet e tyre **obligohen të zbatojnë masat** për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji.”<sup>4</sup> Për më tepër, Neni 6 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh qartë se “**Përfaqësimi i barabartë gjinor** në të gjitha organet legislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike **arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse**” (Neni 6, alinea 8).

<sup>1</sup> Shih Profilin GjinortëVendit: Analizë e DallimeveGjinorenëtëgjithaniveletnëKosovë. Shih faqe 16.Përgaditur ngaOrgut Consulting përAgjencinëpërBaraziGjinoretëKosovës, Prishtinë.Në [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit\\_2014%20-ALB.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf).

<sup>2</sup> Shih LigjinpërZgjedhjet e PërgjithshmenëKosovë Nr. 03/L-073 sidheLigjipërZgjedhjetkomunale Nr. 03/L-072, nenet 27.1 dhe 7.2 tëligjevepërkatëse duke cekur se nëlistën e kandidatëvetësecilitsubjektpolitikësëpakutridhjetë (30 %) përqindjanëmshkujdhesëpakutridhjetë (30 %) përqindjanëfemra; me nganjëkandidattësecilësgjinipërfshirësëpakunjëherënesecilingrupprejtrekandidatëve, e qënumërohetngakandidati i parënëlistë.

<sup>3</sup> Shih Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës, Nr. 05/L-020.Në <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>

<sup>4</sup> Ibid, Neni 14 e LigjitpërBaraziGjinore.

Të njejtin konstatim e ka ofruar edhe Avokati i Popullit të Kosovës i cili shprehimisht kërkon nga partitë politike të zbatojnë kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore para zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura me datën 11 qershor 2017. Për më tepër Avokati i Popullit shprehimisht cek se për të hequr hezitimet eventuale juridike rikujton Komisionin Qendror Zgjedhor të Kosovës si dhe partitë politike se “...Për të siguruar barazinë mes burrave dhe grave dhe zbatueshmërinë e këtij standardi të të drejtave të njeriut, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore...saktëson shprehimisht se “Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.”<sup>5</sup>Kjo kërkesë në rast të adoptimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor të Kosovës, gjatë certifikimit të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtur me datën 11 qershor 2017, do të avanconte pozitën e gruas në parti politike. Ekziston mundësia që në zgjedhjet e ardhshme lokale të kërkohej azhurnimi i rregullave zgjedhore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore lidhur me përfaqësimin gjinor brenda partive politike si dhe të kërkohej zbatimi i dispozitave ligjore në mënyrë progresive me qëllim që të arrihet përfaqësimi gjinor i gjinisë më pak të përfaqësuar në minimum prej 50%.

Disa nga partitë politike, përjashtuar AAK-në, Nisma për Kosovën, LDK-në, e kanë nga një grua si zëvendëskryetare dhe e kanë kuotën për pjesëmarrje të grave.<sup>6</sup> Mirëpo, nga hulumtimet në terren po ashtu është vërejtur se respektimi i kuotës gjinore në përgjithësi si dhe pozita e grave brenda strukturave partiake mbetet e brishtë. Partitë në fakt e shohin më shumë kuotën si detyrim për shkak të kërkesave të ligjeve por jo edhe domethënëse.

Sa i përket analizës së pjesëmarrjes së grave në politikë, në përputhje me rekomandimet e NDI në vitin 2015, partitë politike kanë përmirësuar programet dhe politikat në zgjedhjet e fundit qendrore për të tërhequr votat e grave votuese.<sup>7</sup> Mirëpo jo domosdoshmërisht partitë kanë bërë analiza paraprake në aspektin gjinor të programeve e as shoqëria civile nuk ka ushtruar presion për të kërkuar programe të tilla. Perspektiva gjinore do të duhej të mirrte parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave dhe hartimin e programeve në përputhshmëri me këto nevoja dhe interesat.Edhe pse është vërejtur një përmirësim në programet politike të partive në zgjedhjet e fundit qendrore, jo domosdoshmërisht këto thirrje kanë qenë edhe sensitive nga aspekti gjinor. Është vërejtur se shumica e programeve të partive politike në zgjedhjet e fundit qendrore nuk ishin lehtë të qasshme në faqet zyrtare të partive politike ose nuk ekzistonin fare në webfaqet e tyre zyrtare. Disa prej pikave të programeve politike kanë adresuar në mënyrë specifike deri në një masë interesat dhe brengat e grave votuese në veçanti.<sup>8</sup>

---

<sup>5</sup>Neni 5, paragrafi 2 i Ligjit për Barazi Gjinore. Shih deklaratën e Avokatit të Popullit të datës 19.05.2017 në <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-PERFAQESIMIN-E-BARABARTE-GJINOR-NE-LISTAT-E-KANDIDATEVE-NGA-SUBJEKTET-POLITIKE-1511>

<sup>6</sup> Shih Profilin Gjinor të Vendit: Analizë e Dallimeve Gjinore në të Gjithanive të Kosovës. Shih faqe 19. Përgaditur nga Orgut Consulting për Agjencinë për Barazi Gjinore të Kosovës, Prishtinë. Në [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit\\_2014%20-ALB.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf).

<sup>7</sup> Shih Raportin e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI), “Kosovë: Tejkalimi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politikë,” Shkurt 2015, faqet 5-6. Në <https://www.ndi.org/sites/default/files/Gender-Assesment-report-ALB.pdf>.

<sup>8</sup>Për shembull Levizja Vetëvendosje adreson në programin e vet zgjedhor nevojat dhe interesat e grave për të apeluar të votueset gra. Mbetet të shihet sa ka ndikuar programi në fjalë pas analizës së numrit dhe ndarjeve gjinore në rritjen e numrit të partisë në fjalë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 11 qershorit 2017. Shih Programin e Lëvizjes Vetëvendosje, pika 6 rritja e subvencioneve për gra fermere në bujqësi, pika 8 rritja e mundësive për banim social për gratë, pika 9 zgjidhja e çështjeve pronësore me fokus të vecantë në gratë, Pika 16 sigurimet shëndetësore si dhe shtesat e fëmijëve të cilat do të i lëshohen në emër të nënës, pika 17, etj. Për

Gjatë fushatës për zgjedhjet nacionale me 11 qershor 2017, gratë kandidate kanë vazhduar të ankohen për mungesën e mbështetjes nga ana e partive politike sikurse për kandidatët burra. Politikanet gra ankohen se partitë politike ofrojnë financim të kufizuar për fushatat zgjedhore të kandidateve gjë që dëmton mundësinë e tyre për të siguruar vota, shpesh me vetë-financim nga ana e grave kandidate për deputete.<sup>9</sup> Shpesh puna në terren e grave në politikë mbetet si iniciativë vetanake dhe e ndikuar nga konkurrenca jo-lojale brenda partiake.<sup>10</sup> Këtë e tregojnë edhe shpërndarja e fondeve publike të cilat ndahen nga Kuvendi i Kosovës, për çdo vit si mbështetje për partitë politike parlamentare. Mirëpo, gratë në politikë pajtohen që nuk ndahen këto fonde në mënyrë proporcionale dhe transparente.<sup>11</sup> Poashtu gratë gjatë fushatave zgjedhore ballafaqohen me praktika diskriminuese duke i propozuar në numër të vogël në rolin e vëzhgueseve apo komisionereve gjatë procesit të zgjedhjeve.<sup>12</sup> Gratë shpesh lihen edhe jashtë listave nëse nuk janë të preferuara nga lidhshipi partiak, ndërsa në rastet kur janë në listë nuk i nënshtrohen garës fer.

## **b) PËRFAQËSIMI I GRAVE NË POZITA VENDIM-MARRËSE**

Trendi i përfaqësimit të ulët të grave brenda partive politike vazhdohet edhe me rastin e emërimit të grave në pozitat vendimarrëse. Kur propozohen kandidatët, në degët e partive rrallë herë emërohen gra. Liderët e degëve zakonisht janë ndër të parët që propozohen, dhe krejt pak janë gra. Degëve të partive u mungon strategjia për rekrutim dhe vazhdimi i qëndrimit si anëtare në parti pas përfundimit të zgjedhjeve, dhe kanë një rreth të vogël të kandidatëve potencial për të zgjedhur.<sup>13</sup> Si rezultat, selitë e partive shpesh duhet të përfshijnë kandidatët e tyre gra për të plotësuar kuotën duke i anashkaluar të nominuarit e degës.<sup>14</sup>

Në vitin 2014 gratë pas zgjedhjeve nacionale kanë vazhduar të mbesin të nën-përfaqësuara edhe në nivelin komunal si dhe atë qendror.<sup>15</sup> Në zgjedhjet komunale të vitit 2013, për herë të parë në Kosovë një grua e fitoi pozitën e kryetares së komunës në Gjakovë dhe dy gra u emëruan Kryesuese të Kuvendit Komunal në Gjilan dhe Lipjan. Në nivelin e emërimit të grave si drejtore në ekzekutivin komunal mesatarisht në 10 nga 14 drejtori komunale, shumica janë udhëhequr nga burrat, ndërsa në disa komuna nuk kishte fare gra apo ishin emëruar nga 1 ose 2 drejtore gra. Derisa në komunën e Drenasit dhe Zubin Potokut ka pasë përfaqësim të barabartë ose më të lartë të grave, në Komunën e Dragashit nuk kishte drejtore grua.<sup>16</sup> Në komitetet obligative për politikë dhe financa si dhe në

---

pikat e tjera shih Programin e 40 pikave të Lëvizjes Vetëvendosje në <http://www.vetevendosje.org/Al/prioritetet-e-republika-laquo-s/12820/prioritetet-e-republikes/>.

<sup>9</sup> Shih më lartë raporti NDI supra note 7.

<sup>10</sup> Citat nga diskutimi me gratë e partive politike si dhe gratë e asambleve komunale, në Mamushë 20 maj 2017.

<sup>11</sup> Diskutime me gratë në politikë, Bogë 30 qershor, 1, 2 dhe 3 korrik 2017.

<sup>12</sup> Supra note at 11.

<sup>13</sup> Raporti NDI, 2015.

<sup>14</sup> Shih Profilin Gjinor të Vendit: Analizë e Dallimeve Gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë. Shih faqe 19. Përgaditur nga Orgut Consulting për Agjencinë për Barazi Gjinore të Kosovës, Prishtinë. Në [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit\\_2014%20-ALB.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf)

<sup>15</sup> Gratë kanë mbajtur 33.3% të ulëseve në Kuvendin e Kosovës (40 nga 120 ulëse) gjersa prej tyre 14 gra janë zgjedhur, ndërsa kuota ka mundësuar që 24 gra të tjera të fitojnë vendet e tyre. Shih Profilin Gjinor të Vendit: Analizë e Dallimeve Gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë. Shih faqe 17. Përgaditur nga Orgut Consulting për Agjencinë për Barazi Gjinore të Kosovës, Prishtinë. Në [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit\\_2014%20-ALB.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf)

<sup>16</sup> Diskutime me grate në politikë dhe grate e shoqërisë civile, qershor 2017.

komitetet për komunitete përfaqësimi i grave ka qenë minimal.<sup>17</sup> Analiza gjinore në vitin 2014, kishte treguar se gratë vazhdojnë të jenë dukshëm të nën-përfaqësuara në pozita vendimmarrëse në komuna, duke udhëhequr vetëm 14 drejtori në tërë Kosovën (4.4%).<sup>18</sup>

Kjo ishte e kundërta nga kërkesat reale në terren meqë në zgjedhjet lokale të vitit 2013 është ndryshuar edhe struktura udhëheqëse në mbi 50% të komunave të Kosovës. Vlerësohet se kanë votuar 15% më shumë gra se sa burra në zgjedhjet lokale të vitit 2013.<sup>19</sup> Pra, partitë politike nuk përcollën vullnetin e shprehur nga gratë për pjesëmarrje më të lartë në zgjedhje dhe në marrjen e votave me emërimin edhe të më shumë grave në pozitat vendim-marrëse pas themelimit të organeve ekzekutive komunale.

### c) GRATË NË MEDIA

Nga monitorimi i fushatës zgjedhore është vërejtur se përfaqësimi i grave në politikë nga partitë si dhe mediat ka qenë më evident mirëpo jo sensitiv nga aspekti gjinor. Spotet televizive të përdorura nga ana e partive politike shumë shpesh kanë përdorë mesazhe jo sensitive nga aspekti gjinor duke përfaqësuar rolin e grave në mënyrë stereotipike gjinore. P.sh debatet lidhur me çështjet të cilat konsiderohen të grave sikurse shëndetësia, mirëqenia sociale, kujdesi për familjen, mungesa e institucioneve parashkollore për fëmijë, etj.<sup>20</sup> Poashtu edhe mesazhet në spotet televizive ishin stereotipike për rolet që kanë në shoqëri gratë dhe burrat.<sup>21</sup> Për më tepër, përfaqësimi i grave në debate publike ka qenë i ulët.<sup>22</sup>

Në shumë emisione parazgjedhore dhe zgjedhore është vërejtur përfaqësimi i ulët i grave në debate, ndërsa mediat dhe partitë politike nuk kanë shfrytëzuar rastin të promovojnë gratë në pozitat udhëheqëse. Sipas mediave kjo shpesh ndodh edhe nga “hezitimi” i grave që të dalin në debate apo edhe nga vetë partitë politike të cilat dërgojnë debatues burra edhe pas kërkesës së mediave që të kenë më shumë gra në debate.<sup>23</sup> Sipas disa mediave nuk ka as gra “adekuate” për të diskutuar, përpos se edhe partitë i dërgojnë vetë kandidatët e tyre të preferuar.<sup>24</sup> Poashtu edhe hulumtimi i Komisionit të Pavarur për Media (KPM) në nëntor të vitit 2013, nga monitorimi i tre televizioneve si RTK, KTV dhe

---

<sup>17</sup>Iniciativa e të rinjve “Gjysma e Popullatës, përfaqësimi i drejtë,” Punuar nga Saranda Bllaca. Shih Courtesy copy NDI-Kosovo, 2015.

<sup>18</sup>Shih ProfilinGjinortëVendit: Analizë e DallimeveGjinorenëtëgjithaniveletnëKosovë. Shih faqe 17.Përgaditur ngaOrgut Consulting përAgjencinëpërBaraziGjinoretëKosovës, Prishtinë.Në [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit\\_2014%20-ALB.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf).

<sup>19</sup>Ibid.

<sup>20</sup>Për shembull ne spotin televiziv të partisë AAK, për kandidatin për kryeministër duke përfaqësuar rolin në shoqëri të grave në baza fisnore, me sequenca të pozitës sociale dhe udhëheqëse të djemve të rinj dhe burrave gjersa tregohen vajzat e reja në role stereotipike dhe tradicionale.

<sup>21</sup>Shih për shembull citatin “Shteti i ka dy duar. Dorën e babait dhe dorën e nënës. Dora e babait është policia, gjyqësia, prokuroria e ushtria, ndërsa dora e nënës është shëndetësia, arsimiti, kultura e kujdesi social. Ne dëshirojmë ta theksojmë këtë dorën e nënës si kujdes të shtetit ndaj qytetarit.” Shih faqen zyrtare të Albin Kurtit, Levizja Vetëvendosje në <http://bit.ly/2rMQd22>

<sup>22</sup>Intervistë me kryeredaktorët e mediave KTV dhe Express emisionit “Komiteti,” realizuar nga Grupi Gratë në Lidërsip, maj-qershor 2017.

<sup>23</sup>Ibid.

<sup>24</sup>Intervistë me kryeredaktorët e emisionit Komiteti, Express, maj-qershor 2017.

RTV 21, ka treguar se përfaqësimi i grave ka qenë shumë i ulët në krahasim me burrat. Në vitin 2013, RTK ka ofruar hapësirë për gra me 5,21%, në KTV me 7,72% dhe RTV21 vetëm 4,20%.<sup>25</sup>

Shumica e grave kandidate për deputete në zgjedhjet qendrore të qershorit 2017, pajtohen se mediami i vetëm ku kanë pasur qasje të drejtëpërdrejtë gjatë fushatës zgjedhore janë mediat sociale sikurse Facebook, Instagram dhe Twitter. Shumica e grave poashtu pajtohen se përdorimi i mediave sociale në zgjedhjet e fundit qendrore ka qenë i limituar për shkak se koha ishte e shkurtë për përgatitje meqë ishin zgjedhje të jashtëzakonshme. Mirëpo, gratë pajtohen që kanë nevojë për trajnime për përdorimin dhe mënyrën e zhvillimit të fushatës zgjedhore nëpërmjet mediave sociale.<sup>26</sup>

## REKOMANDIMET

Bazuar në të gjeturat e dhëna më sipër, në bazë edhe të mësimave të nxjerra nga zgjedhjet e kaluara, grupi ofron rekomandimet si më poshtë:

### PARTITË POLITIKE:

- Partitë politike, në zgjedhjet e ardhshme lokale, duhet të sigurohen që programet e tyre të jenë më sensitive nga aspekti gjinor si dhe të nxjerrin mësim nga zgjedhjet qendrore për të reflektuar me veprime konkrete lidhur me përfaqësimin e barabartë, me qëllim që të tërhiqen votat e grave votuese.
- Përderisa disa parti, në platformat dhe programet e tyre zgjedhore, i trajtojnë më shumë çështjet gjinore, këtë mund ta bëjnë të gjitha partitë duke rritur përfshirjen gjinore. Mund të ketë më shumë iniciativa për të punuar me burrat brenda partive në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe gratë në politikë të nivelit komunal për t'i mbështetur analizën dhe përfshirjen gjinore të mesazheve parazgjedhore dhe zgjedhore.
- Në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve partitë politike do të duhej të punojnë në azhurnimin e rregullave zgjedhore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore lidhur me përfaqësimin gjinor brenda partive si dhe të kërkohet zbatimi i dispozitave ligjore në mënyrë progresive me qëllim që të arrihet përfaqësimi gjinor i barabartë për gjininë më pak të përfaqësuar, minimum 50%.
- Angazhimi i grave brenda partive politike në pozitat vendim-marrëse do të duhej të konsiderohej si një mundësi përpara në nivelin lokal, ku në dy prej udhëheqësve të ekzekutivit komunal një do të duhej të jetë grua si dhe rritjen e numrit të grave në ekzekutivin komunal sipas kërkesave të Ligjit për Barazi Gjinore.
- Lobet për Barazi Gjinore të themeluara pas zgjedhjeve lokale të përbëra nga gratë në asamble komunale si dhe shoqëria civile do të duhej të ofrojnë në secilën komunë edhe emra të grave në politikë për pozitat e drejtorëve në komuna.
- Degët e partive politike në nivelin lokal duhet t'i promovojnë gratë kandidate në debate publike duke përzgjedhur përfaqësimin e grave në tema të ndryshme, jo vetëm tema stereotipike gjinore. Kjo qasje e partive duhet të shihet si strategji për apelimin tek gratë votuese.

<sup>25</sup> Komisioni i Pavarur i Mediave, Shih linkun ne <http://www.kpm-ks.org/?mod=njoftimet&id=400>, “Prezantimi i gruas në media.”

<sup>26</sup>P.sh. model i mirë mund të mirret “Shkolla për Mediat e Reja” (New Media School) e cila ofrohet nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), për partitë politike në baza vjetore.



- Partitë politike në bashkëpunim me KQZ-në, të obligohen të propozojnë gra në rolin e komisionerëve dhe vëzhguesve, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore.

#### **MEDIAT DHE SHOQËRIA CIVILE:**

- Mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm në paraqitjen e më shumë grave eksperte në role gjinore jo-stereotipike. Në këtë drejtim edhe shoqëria civile në bashkëpunim me partitë politike do të duhej të propozojnë edhe një listë të grave për debate në varësi nga temat e propozuara dhe ekspertiza. Duhet të krijohen grupe të avokimit për barazi gjinore nëpër komuna të cilat mund të bëjnë bashkë gratë e politikës dhe të shoqërisë civile në rrjete mbështetëse drejt avancimit të barazisë gjinore.
- Të ofrohen trajnime nga shoqëria civile dhe donatorët në bashkëpunim me partitë politike për përdorimin e mediave sociale për gratë candidate në zgjedhjet lokale.
- Shoqëria civile në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të vazhdojnë të hulumtojnë pjesëmarrjen e grave në politikë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, për të promovuar rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në proceset vendim-marrëse.

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen zemërgjërë të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e shprehura përmes kësaj platforme janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

